



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.11/2017

Prishtinë, më 7shkurt 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj Halimaj.

Munguan: Frashër Krasniqi dhe Mytahir Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Shyqiri Bytyqi, ministër MASHT-it, Kumrije Gagica-MASHT, Teuta Prekazi-UN Human Rights, Hajrudin Skenderi- Ambasada e Zvicrës, Violeta Haxholli-KDI, Qendresë Mustafa-BIRN, Besa Bytyçi-MASHT, Dritë Slivova-KTV, Dafina Jegeni-Klan Kosova, Albana Bajrami-RTK RADIO, Edona Kutleshi-Koha Ditore, Nerënxa Jakupi- Kosova Press, Albulena Nuha-RTV-21, Adem Gashi-OSEP, Arbisa Shefkiu-Epoka e Re.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Raportimi i z. Shyqeri Bytyqi, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me çështjen e nostrifikimit të diplomave dhe zbatimin (moszbatimin) Marrëveshjes për njohjen e diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit;
3. Të ndryshme.

1.Raportimi i z. Shyqeri Bytyqi, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me çështjen e nostrifikimit të diplomave dhe zbatimin (moszbatimin) Marrëveshjes për njohjen e diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;

Duda Balje, kryetare, falënderoi z.Shyqiri Bytyqi, Ministër i MASHT-it, që ju ka përgjigjur ftesës së komisionit dhe tha se ai është i ftuar në lidhje me nostrifikimin dhe njohjen e diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pas ankesave që kemi pranuar në Komision.

Shyqiri Bytyqi, ministër, tha se brenda MASHT-it, ekziston një departament i veçantë NARIK Kosova-Qendra Kombëtare për Njohjen e Diplomave, që merret me nostrifikimin e diplomave. Ky departament për shkaqe të ndryshme ka pasur probleme në nostrifikimin e diplomave, jo vetëm të shtetit të Serbisë por edhe të vendeve të tjera. Problem kyç kemi me Shqipërinë, por çështja e nostrifikimit të diplomave me Serbinë ka pasur edhe me implikime politike dhe për këtë arsye ka pasur bisedime të drejtpërdrejta në Bruksel, ku faktikisht janë arritur dy marrëveshje që lidhen me nostrifikimin e diplomave. Marrëveshja e parë është arritur në vitin 2011, kurse e dyta në vitin 2016.

Për marrëveshjen e parë është formuar një grup profesional për ti analizuar diplomat të cilat vinë nga Serbia dhe për t'i nostrifikuar, qëpari mbështetje edhe nga Bashkësia Evropiane, për të cilën kryesisht ka qenë e angazhuar edhe organizata joqeveritare Holandeze SPARK, e cila ka ndihmuar mjaft për ta çuar procesin përpara në njohjen e diplomave.

Kjo formë ka dhënë rezultate, ndërsa tek marrëveshja e dytë e cila është arritur në vitin 2016, për shkaqe teknike dhe politike, ajo nuk arriti të zbatohet tutje.

Kam pasur takim të drejtpërdrejt me ministrin e Arsimit të Serbisë, kemi biseduar për çështjen e lehtësirës së fillimit të procedurës për njohjen e diplomave, nuk pati një gatishmëri të madhe nga pala serbe, sepse ai e ka konsideruar akoma si fazë politike edhe pse ekziston një marrëveshje politike për njohjen e diplomave. Tani me departamentin përkatës të MASHT-it jemi në një fazë të mirë, kemi bërë një auditim të brendshëm dhe kemi parë ku janë dobësitë që kanë shkaktuar vonesat në njohjen e diplomave në përgjithësi dhe këto problematika thuajse i kemi në përfundim e sipër për ti mënjanuar .

Sa i përket rastit konkret që u përmend, Bytyqi tha se ka pasur takim direkt me profesorin për të cilin ka kërkuar mirëkuptim edhe nga Universiteti i Pejës që ti vazhdohet kontrata e punës për shkak se kemi konsideruar se ndoshta shkaqet teknike kanë mundësuar shkëputjen e kësaj kontrate dhe sipas informacioneve është gjetur mirëkuptim që personit në fjalë ti vazhdohet kjo kontratë deri në zgjidhjen përfundimtare të problemit.

Kryetarja, tha se ka informata që departamenti NARIK Kosova dy vite nuk ka qenë aktiv, a keni informata sa aplikime i keni tash të dorëzuara në Ministri për nostrifikim, vetëm nga ana e boshnjakëve me diploma të Serbisë, ndërsa theksoi se sipas informatave që ajo ka, janë 120 sosh.

Teuta Haxhiu, tha se ka një informatë se dikujt i është bërë nostrifikimi i diplomës brenda ditës, por ka raste të tjera që presin me vite. Kam bërë edhe dy pyetje parlamentare, por sa i përket këtij komuniteti, aplikacionet që ju janë parashtrua juve si ministri a i keni dokumentet për me pa se këto programe në shtetet e rajonit prej nga janë diplomat a janë ato programe të akredituara, dhe nëse janë të akredituara atëherë pse të diskriminohet komuniteti boshnjak apo edhe komunitete e tjera krahasuar me komunitetin serb, të jetë një vendim i njëjtë për të gjithë. Ndërsa tha se me NARIK Kosova, është shumë e dëshpëruar, meqë personalisht kam marrë një informatë për një profesor, i cili për tri vite nuk kishte marrë përgjigje.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se ministrin e kemi këtu për një çështje konkrete dhe të kemi një përgjigje konkrete për çështjen e profesorit nga komuniteti boshnjak që na është drejtuar neve si komision dhe pse nuk po gjen zbatim marrëveshja e arritur në Bruksel.

U tha se është ndërprerë procesi, pse nuk po vazhdon, përveç diplomave nga Serbia kemi edhe shumë diploma në Kosovë, ku shumë qytetarë nga Presheva, Bujanoci dhe nga vende të tjera që studiojnë në Kosovë dhe asnjëherë nuk mund ta realizojnë mundësinë e punësimit në Serbi për arsye se nuk ju njihen diplomat.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se çështja e nostrifikimit të diplomave është një çështje e ndjeshme, ka vite që presin studentë për nostrifikim të diplomave si nga Shqipëria ashtu edhe nga vendet e tjera. Më intereson të dijë që nga koha kur ministri, Bytyqi, ka ardhur në Ministri sa aplikues kanë qenë për nostrifikim, prej cilit vend dhe kur pritet të bëhet nostrifikimi i diplomave të tyre, sepse ka aplikacione prej 5 e 6 viteve që presin studentët dhe nuk ju është dhënë asnjë përgjigjeje deri më tani.

Shyqiri Bytyqi, tha se brenda Departamentit të NARIK-ut dhe Ministrisë së Arsimit nuk bëhet fjalë për diskriminim të asnjë komuniteti dhe të asnjë individi, bëhet fjalë për probleme të përgjithshme teknike dhe politike që nuk ka të bëjë me një komunitet të caktuar, problemi nuk është tek ky apo ai person, por është problem politik dhe nuk ka mundur të vazhdojë tutje për t'u zbatuar një marrëveshje e cila ka ekzistuar në 2016.

Sa i përket NARIK-ut, jemi të gatshëm ta bëjmë një raportim të përgjithshëm, për këtë kam qenë i interesuar qysh prej momentit kur e kam marrë detyrën si ministër për arsye se kam pasur shumë ankesa, dhe gjëja e parë që kam kërkuar ka qenë që të kemi një auditim special vetëm për Narik-un, për ti parë se cilat janë problemet në këtë departament që kanë shkaktuar këtë konfuzion të madh. Tashmë i kemi informacionet, rezultatet, i dimë shkaqet dhe jemi duke ndërmarrë masa konkrete për të dalë nga kjo situatë. Numri i aplikantëve që kemi gjetur dhe që nuk janë shqyrtuar është mbi 1.000.

Kumrije Gagica, MASHT, tha se në qendrën Narik në muaj kemi 150-200 aplikantë, që është një numër relativisht i madh. Qendra Narik për momentin është me një numër shumë të vogël të stafit. Sa u përket diplomave të Serbisë, u cekë se është një problem politik, prej vitit 2008 e tutje, kur është themeluar qendra NARIK, aplikimet nuk janë pranuar për faktin se gjithmonë është diskutuar për një mundësi dialogu për një marrëveshje, e cila është arrit në vitin 2011, dhe e cila ka nis zbatimin në vitin 2012, të gjithë ata që kanë përfunduar studimet në Serbi pavarësisht komunitetit kanë pasur mundësi të aplikojnë në zyrë e SPARK-ut, e cila ka

funksionuar në Ministrin e Arsimit, aty kanë qenë disa faza. Çdo udhëzim që marrim nga ana e Qeverisë janë të obliguar ta zbatojnë dhe jemi në pritje të Qeverisë se si me vazhduar tutje.

Kryetarja, tha se sa i përket nostrifikimit të diplomave është problem reciprociteti që i bie Serbia nuk pranon diplomat e lëshuara në Kosovë, Kosova nuk pranon diplomat e lëshuara në Serbi, por a jemi duke e respektuar ne si Kosovë reciprocitetin sepse nëse respektohet nuk duhet pranuar asnjë diplome nga ana e Serbisë, sepse ata nuk pranojnë diplomat e Kosovës. SPARK-u ka punuar si projekt dhe më nuk punon, ndërsa Kosova nuk ka respektuar marrëveshjen e reciprocitetit sepse me diploma të Serbisë këtu punohet normal.

Shyqiri Bytyqi, tha se prej çdo shteti që na vinë diplomat për nostrifikim i kanë rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen pavarësisht se nga kush na vjen, në këtë aspekt theksuam se

nuk kemi diskriminim, sa i përket punësimit nuk i takon MASHT-it, të vendos se a i kërkohet dikujt një diplomë e nostrifikuar apo jo, këto janë çështje të institucioneve të tjera.

Sa i përket kësaj ministrie, jemi të gatshëm të fillojmë procedurën teknike të respektimit të procedurës për nostrifikim të një diplome, por nuk varet nga ministria sepse kjo është çështje e Qeverisë dhe e bisedimeve në Bruksel, dhe në momentin kur këto çështje nga ana e dy qeverive të jenë të gatshme, atëherë ne jemi të gatshëm që çështjet teknike ti çojmë përpara, dhe pastaj mund të flasim për reciprocitet.

Kreytarja, tha se kam një propozim që deri në përfundim të bisedave në Bruksel mes dy vendeve, të bëhet një zgjidhje me Qeverinë në lidhje me këto probleme.

Shyqiri Bytyqi, tha se jemi për një zgjidhje më të mirë të mundshme, por ne po flasim për nostrifikim të diplomave, nuk na takon me fol për reciprocitet sepse është përtej MASHT-it, aktualisht është e pamundshme me gjet zgjidhje të përkohshme, nuk i takona MASHT-it, për një periudhë të caktuar mund të punojnë në Universitete pa qenë të nostrifikuara diplomat, e përkohshmja mundet me qenë kjo, derisa të zgjidhen problemet teknike, por vendimet i merr Qeveria.

Teuta Haxhiu, tha se fillimisht e kisha kërkuar atë raport që ju e keni përpara, meqenëse nuk arritëm ti marrim të gjitha shënimet, sa është afati që t'ju kthehet përgjigjja të gjithë atyre që aplikojnë për nostrifikim, përmenda edhe më parë se ka individë të caktuar që brenda ditës marrin nostrifikimin, por ka edhe të tillë që me vite të tëra presin për të nostrifikuar diplomat e tyre, dhe kjo është neglizhencë e zyrtarëve brenda departamentit, ose është fuqia politike e dikujt që me një telefonatë kryen punë. E di një rast që dje brenda ditës e ka marrë nostrifikimin, çka jam ndier tepër mirë, por ka raste që presin me vite pa asnjë përgjigjeje të vetme, dhe më intereson të dijë sa është afati ligjor që ktheni përgjigje.

Kumrije Gagica, tha se është e pamundur të bëhet një nostrifikim i diplomës brenda një dite, përderisa procesi i nostrifikimit nuk është aq i lehtë duhet të kalojë nëpër disa faza, në bazë të

udhëzimit administrativ i kemi 5 ditë afat që të bëjmë kërkesën në Institucionet përkatëse ku pala i ka përfunduar studimet dhe gjithashtu në qendrat NARIK-ut, të shteteve përkatëse duhet të sigurohen përgjigjet, të përpunohen nga zyrtarët në qendra dhe me pas të kalojnë në Këshillin Shtetëror Profesional për njohje apo edhe në një komision të veçantë.

E them me plotë përgjegjësi se nuk është e mundur në Qendrën NARIK Kosova të behet njohja e një nostrifikimi të diplomës brenda ditës, për shkak se një gjë e tillë nuk është e mundur. Sa i përket zgjatjes së procedurave, kur nuk mundemi me i marrë përgjigjet e kërkuara në afat të caktuar atëherë mundet të zgjatet procedura për afat të pacaktuar, dhe pa marrjen e të gjitha informatave nuk mund të procedojmë tutje, por me ardhjen e kabinetit të ri ministror kemi gjetur një përkrahje dhe jemi duke analizuar mundësitë për ti tejkaluar këto probleme.

Qendra NARIK Kosova ende nuk është pjesë e rrjetit ENIK - rrjetit evropian për njohjen e diplomave, jo pse ne nuk dëshirojmë të jemi pjesë e rrjetit por për shkak se pengojnë disa procese.

Siç e dimë Kosova nuk është pjesë e disa institucioneve ndërkombëtare siç është Këshilli i Evropës, UNESCO etj, dhe krejt kjo pamundëson që të jemi pjesë në rrjetin ENIK, edhe pse shumica e shteteve që janë pjesë e këtij rrjeti komunikojnë me ne, në mënyrë vullnetare, përderisa nuk jemi pjesë e këtij rrjeti ndodh që shpeshherë edhe nuk arrimë ti sigurojmë përgjigjet me kohë. Në këtë drejtim na ka ndihmuar shumë qeveria Austriake që nga fillimi.

Teuta Haxhiu, tha se ka fakte se një nostrifikim i një diplome të një personi është kryer dje, kam qenë e lumtur që ka ndodh duke shpresuar që ka fillua të punohet mbarë në këtë departament, por jo duke shkelur procedurat, kur po flasim se me vite të tëra në këtë departament njerëzit nuk kanë marrë përgjigje.

Shyqiri Bytyqi, tha se nëse ka pasur shkelje të procedurave dikush duhet të jep përgjegjësi, por ajo çka varet nga ana e jonë jemi të vendosur ti zgjidhim problemet në përputhje me procedurat që i kemi, jemi në bisedime me Shqipërinë që mos të kemi vonesa në përgjigje, por edhe me çdo vend tjetër por, po paraqiten pengesa në vonesa të pajustificueshme dhe do të tentojmë që ndoshta edhe me rrugë politike ti zgjidhim këto probleme teknike.

Ai theksoi se nuk do te ketë më neglizhencë në punë dhe për këtë jemi të hapur kushdo që ka informacione për shkelje të procedurave, do ti diskutojmë, do t'i bëjmë publike dhe do të merren masa konkrete.

Kryetarja, në fund falënderoi ministrin Bytyqi për pjesëmarrje dhe përgjigjet që i dha për komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje